

Më 7 prill 2026 u zhvillua online Takimi i 9-të i Koordinimit të projektit SINCERE, ku partnerët diskutuan mbi ecurinë e projektit dhe hapat e mëtejshëm. Fokusi kryesor ishte rishikimi pas dorëzimit i deliverable-ve të muajit të gjashtë (M6) në platformën SyGMA dhe komentet fillestare të Oficerit të Projektit të Komisionit Evropian. U konfirmua se dy deliverable janë miratuar pa komente, ndërsa tre të tjera kërkojnë vetëm përmirësime të vogla teknike për ridorëzim.

Në vijim, u trajtuan zhvillimet në paketat e punës: në WP2 po vijon analiza e pyetësorëve dhe përgatitja e Kornizës së Integritetit Akademik; në WP3 u diskutua progresi i procedurave të prokurimit të centralizuar të softuerëve; ndërsa në WP4 partnerët u nxitën të përditësojnë aktivitetet e shpërndarjes dhe të planifikojnë eventet e brendshme të promovimit.

Gjithashtu, u diskutua vlerësimi periodik i rrezeve dhe çështje të tjera në zhvillim, përfshirë organizimin e një takimi të dedikuar për komponentin e dashboard-it të projektit.

